



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 12.02.2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 171/2014 “PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE TË KALIMIT TË TOKËS
BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË
PËRFITUESVE”, TË NDRYSHUAR**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datave 24.10.2018 dhe 12.02.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatorë për shqyrtimin e këtij projektligji deputetët Klotilda Bushka (Ferhati) dhe Bashkim Fino.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit, ishin të pranishëm z. Erjon Braçe, në cilësinë e deputetit që ka depozituar nismën ligjvënëse; znj. Ermira Gjeci zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe përfaqësues të kësaj ministrie, znj. Teuta Voda, zëvendësministrie e Drejtësisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar si nismë deputeti, në mbështetje të përcaktimeve të neneve 81 pika 1, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ligji aktual nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore, të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, ka për objekt përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, të ish ndërmarrjeve bujqësore, përfituesve sipas ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë bërë kalimin në pronësi, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara nga ligji i vitit 1995.

Ndarja e tokës bujqësore, dhënia e saj në përdorim e më pas, kalimi në pronësi është shoqëruar me mangësi e probleme të ndryshme. Adresimi i këtyre mangësive solli si nevojë miratimin e ligjit nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve ishte parashikuar data 30 Qershor 2016. Me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë ka shtyrë nëpërmjet ligjit nr.63/2016, datë 2.6.2016 afatin e përfundimit të procedurave të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfituesve fillimisht deri në datë 31.12.2017 dhe më pas nëpërmjet ligjit nr.102/2017, datë 30.11.2017, ky afat është shtyrë deri në datë 31.12.2018.

Projektligji i depozituar si nismë deputeti është propozuar si pjesë e paketës për ndryshime ligjore në legjislacionin në fuqi që trajton procedurat e kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve. Qëllimi i këtij projektligji është rishikimi i disa dispozitave të ligjit aktual, të cilat kanë krijuar problematika në zbatimin e tij, dhe që janë të lidhura me çështjet e mëposhtme:

a. Shumë familje bujqësore apo pjestarë të këtyre familjeve, të cilët kanë përfitur tokë në përdorim sipas dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, nuk mund të pajisen me aktin e marrjes në pronësi të tokës për shkak të kufizimeve të vendosura në legjislacion për mos ndryshimin e vendbanimit.

b. Për shkak të vonesave për transferimin e dokumentacionit të gjendjes civile përtej afateve të përcaktuara në legjislacion, shumë familje bujqësore pavarësisht se kanë qënë banor “de facto” të njërive vendore të ish- ndërmarrjeve bujqësore nuk mund të pajisen me aktin e marrjes së tokës në pronësi.

c. Komisionet e tokës në fshat, në shume raste, nuk kanë plotësuar të plotë dhe të saktë dokumentacionin për përfitimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) për të gjitha familjet bujqësore, pavarësisht se këto familje i plotësonin kriteret ligjore për të qënë përfitues.

Për adresimin e këtyre problematikave projektligji parashikon:

- i. Heqjen e kufizimit përse i takon kriterëve që duhet të përmbushin familjet bujqësore ose individët për mos ndryshimin e vendbanimit të tyre prej datës 1.10.1992. Ky ndryshim do të shërbejë për zgjidhjen e problematikave të përmendura me lart sic ishin dhe vonesat gjatë transferimit të dokumentacionit të gjendjes civile përtej afateve të përcaktuara në legjislacion.

- ii. Riformulimin e nënshkronjes iii), të pikës 1, të nenit 2, të ligjit duke krijuar mundësi për të gjithë familjet bujqësore të cilat disponojnë aktin e marrjes në përdorim për të përfituar aktin e marrjes së tokës në pronësi pavarësisht përcaktimeve përjashtuese të bëra në VKM nr.452, datë 17.10.1992, "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", të ndryshuar. Familjet bujqësore që përdorin tokën do të përfitojnë aktin e marrjes në pronësi vetëm pasi të kenë vërtetuar se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi në qendrat e tyre të mëparshme të banimit.
- iii. Shtimin e dy pikave të tjera të cilat propozojnë, që të jenë subjekt i ligjit, familjet bujqësore, të cilat nuk e disponojnë aktin e marrjes në përdorim të tokës vetëm pasi të kenë vërtetuar se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi në qendrat e tyre të mëparshme të banimit si dhe familjet bujqësore të cilat e disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim, por këtë akt e kanë përfituar pas datës 31.12.1993, për këto të fundit toka do të mbetet në përdorim.
- iv. Zgjatjen e afatit të përfundimit të procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore deri më 30 qershor 2019.

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë bashkitë, këshillat e qarqeve, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtoritë e bujqësisë, Komisioni Qeveritar i Tokës dhe Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe prefektët e çdo qarku.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Në prezantimin e bërë përpara komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nga ana e deputetit nismëtar, u parashtrua se nisma ligjore e depozituar, nuk synon të bëjë rindarje të tokës, por kërkon të avancojë procesin e lëshimit të titujve të pronësisë, mbi tokën bujqësore për familjet, të cilat prej shumë vitesh e përdorimin atë por nuk janë mund të pajisen me Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi.

Relatorët vlerësuan ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore, si nevojë për:

- adresimin e problematikave të evidentuar për sa i takon pajisen me aktin e marrjes në pronësi të tokës për shumë familje bujqësore apo pjestarë të këtyre familjeve, të cilët kanë përfituar tokë në përdorim sipas dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi por për shkak të kufizimeve të vendosura në legjislacion për mos ndryshimin e vendbanimit nuk mund përfitojnë nga e drejta e kalimit në pronësi të tokës bujqësore;
- për të siguruar vijimsinë e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve dhe përfundimin sa më shpejtë të këtij procesi.

Përfaqësuesit e ministrisë së Bujqësisë sqaruan se përfitues të këtyre ndryshimeve ligjore janë punonjësit e ish-ndërmarrjeve bujqësore, përdorues të tokës bujqësore, të cilëve nuk iu transferuar gjendja civile në datën 1.8.1991 si dhe individët që nuk kanë qenë punonjës të

ndërmarrjeve bujqësore por kanë qënë banor sipas regjistrit të gjendjes civile me 1.8.1991 dhe e përdorin tokën bujqësore.

Në vijim nga përfaqësuesit e ministrisë së bujqësisë u argumentua nevoja për shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve në pronësi të përfituesve duke parashtruar se aktualisht janë rreth 25.000 raste të cilat duhet të trajtohen nga bashkitë duke e bërë të domosdoshëm shtyrjen e afatit ligjor për përfundimin e këtij procesi.

Në përfundim të diskutimeve Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut duke marrë në konsideratë që:

- projektligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” i cili ndër të tjera parashikonte shfuqizimin e ligjit nr. 171/2014, nuk u miratua në datën e planifikuar nga Kuvendi, me qëllim qartësimin e disa problematikave që deputetë të Kuvendit hasin në zonat e tyre;
- Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së zbatimit të parashikimeve të ligji nr. 171/2014 i cili përcakton si afat për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve datën 31.12.2018;

vendosi të miratojë projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar bashkë me disa propozime drejtuar komisionit përgjegjës për Veprimtarinë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin, të cilat janë radorduar paraprakisht me përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural si më poshtë vijon:*

IV. PROPOZIME PËR RIFORMULIME NEN PËR NEN

I. Në nenin 1 të projektligjit (i cili ndryshon nenin 2 të ligjit aktual)

- Me qëllim adresimin e problematikës së parashtruar në relacionin shoqërues të nismës dhe me qëllim reflektimin e gjendjes së shumë familjeve të cilat për shkak të mosveprimit në kohë nga institucionet e pushtetit vendor iu është transferuar gjendja civile, pas dt 1.8.1991, pas rakordimit me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë i propozohet komisionit përgjegjës që të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a. Pika 1 të ndryshohet me këtë përmbajtje:
“Nënparagrafi “ii” i shkronjës “a” të pikës 1 shfuqizohet”.
 - b. Pas pikës 1 të shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:
“1/1. Pas shkronjës b) të pikës 1, shtohet shkronja c) me përmbajtjen si më poshtë:
c) Familjet bujqësore ose individët, të cilët përmbushin kushtet si më poshtë:
i) janë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991, gjendja civile e të cilëve u është transferuar në fshatin ku gjendet toka objekt i kalimit në pronësi, pas datës 1.8.1991, por të mos kenë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo pronësi, në fshatin ku kanë patur gjendjen civile më 1.8.1991.

ii) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë.

“1/2 Pas shkronjës c) të pikës 1, shtohet shkronja d) me përmbajtjen si më poshtë:

d) Familjet bujqësore ose individët, të cilët përmbushin kushtet si më poshtë:

i) nuk kanë qenë punonjës të ish ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka bujqësore, objekt i kalimit të pronësisë, sipas regjistrimit të gjendjes civile më 1.8.1991, por të mos kenë përfituar më parë tokë bujqësore në përdorim apo pronësi;

ii) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë.

- Propozimet e paraqitura në nismën e depozituar në pikat 2 dhe 3 përkatësisht për ndryshimin e nënshkronjës “iii”, dhe për shtimin e nënshkronjave “iv” dhe “v”, në përmbajtjen e shkronjës “a” të pikës 1, i rekomandohet komisionit përgjegjës që të hiqen. Kjo pasi edhe në rakordim me ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është vlerësuar se problematika e pasqyruar në relacionin shpjegues e cila ka shërbyer si shkak për ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore adresohet nëpërmjet propozimit të paraqitur më sipër.

- Pas pikës 3, të shtohet një paragraf i ri me si vijon:

“3/1. Në pikën 2 shkronja “b” bëhen këto ndryshime:

a. nënparagrafi “vii” riformulohet me këtë përmbajtje:

“janë dhënë me qira, në bazë të ligjit për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ose ka kaluar në administrim të Ministrisë përgjegjëse për çështje e bujqësisë dhe zhvillimit rural, me destinacion dhënien me qira, sipas legjislacionit në fuqi;

b. pas nënparagrafit “vii” të shtohet nënparagrafi “viii” me këtë përmbajtje:

“viii) janë objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.”

II. Neni 2 (që ndryshon nenin 6 të ligjit aktual)

Komisionit përgjegjës i propozohet shtyrja e afatit të përfundimit të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfituesve edhe me 6 muaj të tjerë. Në këtë aspekt neni 2 sugjerohet të riformulohet si vijon:

“Neni 2

Në nenin 6, pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 Dhjetor 2019.”

III. Duke qënë se afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfituesve sipas parashikimeve të ligjit aktual 171/2014 është mbyllur në datën 31.12.2018, për të siguruar vijimsinë dhe zbatimin e parashikimeve të këtij ligji edhe për periudhën nga data 1 Janar 2019 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i propozohet komisionit përgjegjës shtimi i një **neni 2/1** me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Dispozitë kalimtare

Praktikat ne proces dhe të papërfunduara deri në datën 1 Janar 2019 si dhe aplikimet paraqitura deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji konsiderohen të vlefshme.”

V. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORË

KRYETARI

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

ULSI MANJA

BASHKIM FINO